



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLICA KOSOVA
REPUBLIK OF KOSOVA

Pranuar me: 22.04.2024		
Prilbjen:		
Mjesia Jednica	Numr. Broj	Shtojca Dodatak
01-400/01-19756		

KOMUNA E LIPJANIT
OPSHTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në bazë të nenit 58.pika „i“ të Ligjit mbi Qeverisjen Lokale Nr.03/L-040, „Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës“ nr.28 të datës 4 Qershor 2008, nenit 30 të Ligjit për Menagjimin e Financave Publike dhe pergjegjsit si dhe nenit 40 pika, h“ të Statutit të Komunës së Lipjanit NR.110-78095 te dates 24.12.2021, Kryetari i Komunës së Lipjanit i propozon Kuvendit të Komunës:

Në mbështetje të neneve 12,16 dhe 17 të Ligjit mbi Vetqeverisjen Lokale NR.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28 të datës 04.06.2008, si dhe nenit 20 paragrafi 20.1 te Ligji nr. 08/L-193 mbi ndarjet buxhetore për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2023 ,Statutit te Komunës së Lipjanit NR.110-78095 te dates 24.12.2021, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me datë _____ 2024 miratoi këtë:

Propozim

VENDIM

PËR RITJEN E BUXHETIT TË KOMUNËS SË LIPJANIT NGA TEJKALIMI I TË HYRAVE VETANAKE PËR VITIN 2023

Neni 1.

Me këtë Propozim Vendim të bëhet rritja e planifikimit të buxhetit të të hyrave vetanake në shumë prej 1,185,167.12€. Kështu që vlera e të hyrave vetanake të planifikuara nga 2,337,989.99€ rritet në 3,523,157.12€.

Neni 2.

Mjetet nga Neni 1 i këtij Vendimi planifikohen të destinohen si vijon:

Mallra e Sherbime:

Administrata dhe Personeli (163) Programi (16503) Çështjet gjinore.....	2,500.00€
Shërbimet e Shëndetësis Primare(730) Programi (73200).....	7,743.50€
Arsim dhe shkencë(920) Programi-92250 –Arsimi Parafillor –Qerdhja	25,772.50€
Totali Mallra Sherbime	3 60,16.00€

Investime Kapitale:

Infrastruktura Rrugore (180) kodi i programit 18003:

44511 Bashkfinancimi me Donator.....	313,151.12€
53036 Rikonstruimi i rruges së shkolës në Dobrajë të Madhe dhe rrugica tjera	80,000.00€
Asfaltimi i rrugicave ne fshatrat Krojmir, Kraishte dhe Asfaltimi i rrugës me trotuar ne Fshatin Zllakuqan faza V (projekt i ri)	240,000.00€
Ndërtimi i urave në fshatrat Akllap, Janjevë, Banullë- faza III (Projekt i Ri).....	42,000.00€
Ndërtimi i Infrastruktures te Memoriali i UÇK-së ne fshatin Shalë (Projekt i Ri).....	25,000.00€
Totali Infrastruktura Publike.....	700,151.12€

Shërbimet kulturore (850)-Programi (85003)

54350 Furnizimi dhe vendosja me bari sintetik dhe infrastruktura tjeter ne fushat sportive në Magurë dhe Dobraje e Madhe.....	220,000.00€
Ndertimi i Infrastruktures ne Sallat e Sporteve ne Gllogovc dhe Rufe te Ri (projekt i ri).....	118,000.00€
Totali Sherbimet Kulturore.....	338,000.00€

Arsim dhe shkence(920) Programi-93060

51091 Ndërtimi i shkollës së re në Ribar të Madh.....	27,000.00€
Ndertimi i infrastrukturës ne Oborrin e Shkolles fillore ne fshatin Ribar i Madh.....	84,000.00€
Totali Sherbimet Kulturore.....	111,000.00€

Totali i rritjes së të hyrave vetanake për vitin 2023 në krahasim me planifikimin e buxhetit është 1,185,167.12€.

Neni 3.

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Drejtoria për Buxhet dhe Financa.

Neni 4.

Ky Vendim hyn në fuqi 7 ditë pas publikimit ne faqen elektronike të Komunës.

Neni 5.

Me këtë Vendim të njoftohet Drejtoria për Buxhet dhe Financa ndërsa një kopje ruhet në materialin e Kuvendit.

ARSYETIM

Rritja e planifikimit të buxhetit bëhet për shkak të tejkalimit të planifikimit të të hyrave vetanake të vitit 2023.

Ky tejkalim i inkasimit të të hyrave vetanake është si rezultat i një menaxhimi të mirë të inksimit të të hyrave vetanake.

Ky tejkalim i të hyrave vetanake të planifikuara për vitin 2023 propozohet të destinohet për nevojat e Komunës së Lipjanit.

Si rrjedhojë, në mënyrë që të sigurojmë një funksionalitet normal të organizatës sonë buxhetore, është e nevojshme ndarja e këtij buxheti shtesë në kategoritë e cekura më lartë.

Kryetari i Komunës:
Imri Ahmeti

